

# ZBULUESIT

## Bazat e drejtuesit

*Të zbulojmë se si t'ua mësojmë fëmijëve Fjalën e Perëndisë në mënyrë efektive.*

# Tabela e përmbajtjes

Kapitulli 1 – Rëndësia e shërbesës së fëmijëve dhe filozofia e Zbuluesit.....	3
Kapitulli 2 – Drejtuesit e Zbuluesit .....	9
Kapitulli 3 – Pjesët përbërëse të programit.....	12
Kapitulli 4 – Të lidhesh me familjet.....	30
Shtojca:	
Lidhja me Awana-n .....	32
Historia e “Discovery Land Global” .....	32

# Kapitulli 1

## Rëndësia e shërbesës së fëmijëve

Ndarja e Ungjillit me fëmijët dhe dishepullimi i tyre për të qenë ndjekës të Jezusit gjatë gjithë jetës, është përgjegjësi e kishës lokale.

### Perëndia i do dhe i çmon fëmijët

- Te Mateu 19, Jezusi na e jep shembullin, kur thotë: “I lini fëmijët e vegjël dhe mos i ndaloni të vijnë tek unë, sepse për të tillë është mbretëria e qiejve.” Kjo ishte një ide radikale deri diku, për një kulturë që nuk i vlerësonte fëmijët.
- 1 e Timoteut 2:12 thekson se si ata që janë të rinj mund të bëhen shembull për të tjerët.
- Fëmijët janë shpirtëra që duhen arritur. Nëse nuk kanë besuar në Krishtin, janë të humbur, ecin në errësi, pa qëllim dhe shpresë. Mateu 18:10-14
- Mateu 18:4 flet për besimin si të një fëmije, që çon në aftësinë për të qenë i bindur se qielli është shtëpia e përgjeshme.
- Te Veprat 2:38-39, Luka shkruan që kisha, duke përfshirë fëmijët, mori Frymën e Shenjtë.

### Bibla na thotë ta bëjmë këtë

- Për besimtarët në Krishtin është urdhërim t’u mësojnë fëmijëve Fjalën e Perëndisë – nuk është opsionale apo “bonus” në shërbesë. Disa nga këto urdhërime gjenden te Psalmi 78:1-8, Ligji i Përtërirë 6:6-7 dhe Psalmi 22:30-31.
- Fjala e Perëndisë, te Mateu 2 8:19, na thotë që të “bëjmë dishepuj të gjitha kombet”. Nuk përmendet limit moshe.

### Fëmijëria është një periudhë kritike frymërore

- Studimet kanë treguar se pjesa më e madhe e atyre që ndjekin Krishtin, zgjedhin ta bëjnë midis moshës 4 dhe 14 vjeç, e quajtur shpesh dritarja 4/14. Është e qartë që Perëndia vepron në dhe përmes viteve të fëmijërisë.
- Tek 2 e Timoteut 3:15, Fjala e Perëndisë na tregon se të mësuarit e Shkrimit në moshë të hershme ka shumë ndikim: “dhe se, që nga fëmijëria i njeh Shkrimet e Shenjta, të cilat mund të të bëjnë të urtë për shpëtimin”.
- Satani është gjithmonë duke u sjellë vërdallë, duke kërkuar t’i largojë fëmijët nga Perëndia dhe t’ua ftohë zemrat. Kur ne ndajmë të vërtetën, ne largojmë errësinë. 1 e Pjetrit 5:8
- Nëse ne nuk i kushtojmë rëndësi të mësuarit të fëmijëve, brezi i ardhshëm do të ketë zemra kokëforta ndaj Perëndisë dhe së vërtetës. Kombet shuhen së brendshmi kur nuk e njohin Perëndinë. Psalmi 78:8

### Shërbesa e fëmijëve ka shtrirje të gjerë

- Shërbesa e fëmijëve për hir të arritjes dhe dishepullimit të tyre është mjaftueshëm, por ndikimi shkon përtej tyre. Adoleshentët dhe të rriturit dishepullohen ndërsa shërbejnë, familja e kishës inkurajohet dhe forcohet kur shërbesa e fëmijëve lulëzon dhe është e gjallë, dhe fëmijët sjellin dritë në familjet e tyre, në shkollat dhe komunitetet e tyre.

Shërbesa e fëmijëve është biblike dhe reflekton zemrën e Perëndisë!

**Shënime:** Perëndia të ka dhënë një thirrje të lartë e të shenjtë! Satani sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar se kë mund të përpijë (1 e Pjetrit 5:8). Ai do të donte të të shkatërronte ty dhe shërbesën tënde. Qëndro në lutje dhe kërkoji një grupi njerëzish të luten për ty. Qëndro në Fjalën, qëndro i lidhur ngushtë me Perëndinë e plotfuqishëm dhe në bashkësi me besimtarë të tjerë të së njëjtës mendje.

*1 e Korintasve 15:58: Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se munda juaj nuk është i kotë në Zotin.*

## Çfarë është “Zbuluesit”?

Zbuluesit është një program i krishterë edukues i projektuar për t’u përdorur nga kishat lokale që të ndihmojnë fëmijët të “zbulojnë thesare të përjetshme” në Fjalën e Perëndisë. Është një mënyrë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, që i frymëzon fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Programi është i specializuar në përdorimin e aktivitete praktike, të cilat i sfidojnë nxënësit të flasin për atë që kanë mësuar dhe ta vënë në praktikë. Është një program i qëllimshëm dhe strategjik, që merr në konsideratë zhvillimin frymëror të fëmijës duke filluar nga gjashtë muajsh e duke vazhduar përmes tranzicionit deri në 9-vjeçare.

Kurrikula e Zbuluesit është zhvilluar për t’i mësuar studentët rreth:

1. **Biblës:** pamja e madhe e Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një zbulesë e tërë, e unifikuar, e të vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillit të Jezusit:** shpëtimi prej hirit përmes besimit, siç prezantohet përgjatë gjithë Biblës.
3. **Bazave të krishterimit:** transformimi i jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit të Shkrimit, pagëzimit, darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbimit, misionit etj.

### Kapitull kyç: Fjalët e Urta 2:1-11

Biri im, në rast se pranon fjalët e mia  
dhe i ruan urdhërimet e mia,  
duke i vënë veshin urtësisë  
dhe duke e prirur zemrën ndaj arsyes;  
po, në rast se kërkon me ngulm gjykimin  
dhe ngre zërin për të fituar arsyen,  
në rast se e kërkon si argjendin  
dhe fillon të rrëmosh si për një thesar të fshehur,  
atëherë do të ndiesh frikën e ZOTIT  
dhe ke për të gjetur njohurinë e Perëndisë.  
Sepse ZOTI jep urtësi;  
nga goja e tij rrjedhin njohuri dhe arsye.  
Ai ruan për njerëzit e drejtë një ndihmë të fuqishme,  
një mburojë për ata që ecin me ndershmëri,  
për të mbrojtur shtigjet e drejtësisë  
dhe për të ruajtur rrugën e shenjtorëve të tij.  
Atëherë do të kuptosh drejtësinë, gjykimin,  
të drejtën dhe tërë rrugët e së mirës.  
Kur urtësia të të hyjë në zemër  
dhe njohja të jetë e këndshme për shpirtin tënd,  
shkathtësia do të kujdeset për ty  
dhe arsyeja do të të mbrojë.

#### Shënim për drejtuesin:

Dërgoja grupit të lutjes  
vargjet nga Fjalët e Urta  
2:1-4 dhe kërkoju të luten  
me këto vargje për fëmijët  
në shërbesën tuaj.

## Mësimet bazohen te struktura:

**KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET**

Përqindja e njerëzve që kanë një pikëpamje biblike dhe jetojnë sipas saj, po bie në mënyrë të vazhdueshme. Ne dëshirojmë t'u mësojmë fëmijëve të KUPTOJNË se çfarë është e drejtë sipas Fjalës së Perëndisë, që të mund të MENDOJNË për atë që është e drejtë, gjë e cila më vonë do të caktojë çfarë BËJNË, duke rezultuar në pikën ku ata do të NDIHEN si duhet dhe do të jetojnë një jetë fitimtare në Krishtin.

<b>Kupto si duhet:</b>	<b>Një pasazh kyç nga Shkrimi.</b> 2 e Timoteut 2:15 – Ji i zellshëm të dalësh përpara Perëndisë si i sprovuar, si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që ndan drejt fjalën e së vërtetës.
<b>Mendo si duhet:</b>	<b>Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës.</b> Psalmi 1:2 – Por gjen kënaqësinë e tij në ligjin e Zotit dhe mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e tij.
<b>Vepra si duhet:</b>	<b>Sfida për ta jetuar Fjalën e Perëndisë.</b> Jakobi 1:22 – Por bëhuni bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues, që gënjejnë vetveten.
<b>Ndihu si duhet:</b>	<b>Rezultati i aplikimit të mësimi dhe i të pasurit të një pikëpamje biblike e jo një pikëpamje laike.</b> Psalmi 23

## Ungjilli

Ungjilli shpëtues i Jezu Krishtit është qendror për gjithçka që bëjmë dhe duhet ndërthurur në çdo mësim. Ka vetëm dy lloje nxënësish në klasën tënde: të shpëtuar dhe të pashpëtuar. Shpeshherë, në mënyrë të paqëllimshme, hamendësojmë se nxënësit që vijnë nga familje apo kisha “të mira” e njohin Krishtin si Shpëtimtar, por nuk mund të hamendësojmë kurrë për këtë gjë.

Nevoja urgjente për të komunikuar Ungjillin është e qartë në momentin kur kuptojmë se nxënësit ose do ta kalojnë përjetësinë me Krishtin në qiell, ose do të jenë përjetësisht të ndarë prej Tij.

Nëse neglizhojmë Ungjillin, ka rrezik të nënkuptojmë se shpëtimi fitohet nëpërmjet veprave.

Libri pa fjalë është mjeti që programi i Zbuluesit përdor për të ndarë Ungjillin. Përdorimi i një metode vazhdimisht, ndihmon në eliminimin e paqartësive mes fëmijëve dhe gjithashtu u mëson atyre ta ndajnë Ungjillin me të tjerët.

Është e rëndësishme të theksojmë se Libri pa fjalë është një mjet që siguron një kornizë për ndarjen e Ungjillit; nuk është skenar që duhet ndjekur. Ungjilli duhet ndarë gjithmonë në një mënyrë që e arrin nxënësin në nivelin që është, që i përgjigjet pyetjeve të tij dhe që udhëhiqet nga Fryma e Shenjtë.

Ne nuk e inkurajojmë shumë përdorimin e frazës: “Kërkoji Jezusit të vijë në zemrën tënde”, duke qenë se fëmijët i mendojnë gjërat në kuptimin e drejtpërdrejtë dhe kjo frazë mund të jetë e paqartë për ta.



# LIBRI PA FJALË

## T'U PREZANTOJMË FËMIJËVE UNGJILLIN

Libri pa fjalë është mënyra kryesore se si e ndajmë Ungjillin me fëmijët në kurrikulën e Zbuluesit. Do të vini re se do t'i i referohemi çdo javë ndërsa prezantohet mesazhi i Ungjillit. Secila ngjyrë ka një kuptim të thjeshtë dhe një varg kyç që do t'i ndihmojë fëmijët të marrin kuptimin e vërtetë të dashurisë së Perëndisë dhe të mënyrës se si mund të kemi një marrëdhënie personale me Të, tani e në përjetësi.

Libri pa fjalë është një mjet që paraqet një mesazh të qartë të Ungjillit. Për fëmijët më të rritur, mund t'ju duket si një mjet shumë i përsëritur, por pasi rishikuar rezultatet e testit, mësuam se fëmijët më të rritur dinë fjalën kyç, ngjyrën dhe vargun, por shpesh nuk dinë ta përdorin si mjet për të ndarë apo mbrojtur besimin e tyre. Mbajeni në mendje ndërsa modeloni mesazhin e Ungjillit për fëmijët çdo javë.

Përpiquni që me raste ta përdorni prezantimin e Ungjillit pa iu referuar ngjyrave. Pasi të keni përfunduar, pyetini fëmijët se çfarë iu kujton. Ose, filloni ta ndani Ungjillin duke shprehur gëzimin që keni për shkak se jeni pastruar (shpëtuar) nga mëkati në jetën tuaj. Është e rëndësishme të përfshihet gëzimi i të qenët pjesë e familjes së Perëndisë. Kur bëhesh i krishterë, Perëndia është Ati yt Qiellor dhe ti u bashkohesh të gjithë të krishterëve si pjesë e familjes së kishës së Tij.

### **Përdorimi i Librit pa fjalë**

**Ngjyra e artë** – Faqja e artë na kujton dashurinë e Perëndisë për ne dhe se si ne, si të krishterë, mund të kemi sigurinë se një ditë do të shkojmë në qiell. Gjoni 14:2 thotë: “Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend”. Qielli është i vërtetë... dhe është një vend i përsosur e real. Do të jetë i mbushur me gëzim, lumturi, rrugë të arta, me praninë e vetë Perëndisë dhe do të jetë një familje e përsosur. Por diçka nuk është në qiell... dhe ajo është mëkati.

**Ngjyra e errët** – Faqja e errët përfaqëson mëkatin. Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë që është kundër Perëndisë. Shembuj të mëkatis janë kopjimi, vjedhja dhe thashethemet. Këto gjëra nuk do të jenë në qiell dhe janë gjëra që nuk e kënaqin Perëndinë. Romakëve 3:23 thotë: “Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë”. Ndëshkimi i mëkatis është vdekja e përjetshme, që do të thotë se nuk mund të shkojmë në qiell, por ka shpresë...

**Ngjyra e kuqe** – Faqja e kuqe na kujton Jezusin. Jezusi është Biri i vetëm i përsosur i Perëndisë, që erdhi në tokë të jetonte një jetë të përsosur. Për shkak të jetës së Tij të përsosur, vetëm Ai mund të merre ndëshkimin për mëkatin tonë. Hebrejve 9:22b thotë: “...dhe pa derdhur gjak, nuk ka ndjesë”. Jezusi derdhi gjakun e Tij dhe për këtë shkak, Ai është e vetmja rrugë për në qiell. Jo përmes veprave të mira (Efesianëve 2:8-9), por vetëm përmes dhuratës së Jezusit. Pranimi i kësaj dhurate falas nga Jezusi është zgjedhje personale. Por prit, duhet të të tregoj diçka... Jezusi nuk qëndroi i vdekur, Ai u ngrit sërish dhe pati fitore mbi mëkatin!

**Ngjyra e bardhë** – Faqja e bardhë na kujton se, nëse besojmë këto të vërteta, marrim falje për mëkatin tonë. Veprat 16:31 thotë: “Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote”. Beso dhe do të shpëtosh

nga ndëshkimi i mëkatis tënd. Mëkati yt mund të falet dhe ti mund të pastrohesh. Por kjo është një zgjedhje që çdo individ duhet ta bëjë vetë.

**Ngjyra e gjelbër** – Faqja e gjelbër na kujton se, pasi i kërkon Jezusit të falë mëkatin tënd, Ai dëshiron që ti të afrohesh më tepër me Të. Është një *marrëdhënie*, jo një fe. Ai bëhet udhëheqësi i jetës tënde. Për shkak se Ai është udhëheqësi yt, do të duash të rritesh... si bari në muajt e ngrohtë të verës (i gjelbër). 2 e Pjetrit 3:18a thotë: “Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht”. Ne afrohemi me Të kur lexojmë Biblën, kur lutemi dhe kur i bindemi Fjalës së Tij.

Duket fantastike, apo jo? Pavarësisht sa vjeç je, kjo është një zgjedhje që duhet ta bësh vetë! Mund të zgjedhësh ta pranosh sot këtë të vërtetë të mrekullueshme. Nëse dëshiron të zgjedhësh t'i kërkojë Jezusit të jetë Shpëtimtari dhe Zoti yt, duhet të lutesh ose të flasësh me Perëndinë për këtë. Perëndia është real dhe mund të të dëgjojë kur lutesh. Nëse do të doje ta merrje këtë vendim, mund të lutesh tani për këtë:

1. Pranoje që je mëkatar... tregoji për mëkatin që të mundon dhe se ti e di që ai mëkat nuk i pëlqen Perëndisë. (**ngjyra e errët**)
2. Tregoji se beson që Jezusi vdiq dhe mori ndëshkimin për mëkatin tënd. (**ngjyra e kuqe**)
3. Kërkoji personalisht Jezusit të falë mëkatin tënd dhe të bëhet udhëheqësi i jetës tënde. (**ngjyra e bardhë**)
4. Falënderoje që të ka falur dhe që u bë udhëheqësi i ri i jetës tënde.

Nëse vërtet i ke kërkuar Perëndisë të të shpëtojë dhe të bëhet udhëheqësi i jetës tënde, duhet të dish që mëkati të është falur dhe ti je fëmijë i Perëndisë.

## Këshilla shtesë

Për të ndihmuar në udhëzimin e fëmijëve drejt shpëtimit, programi i Zbuluesit siguron kartën *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*.

**T'i udhëzosh fëmijët për shpëtim**

Pasi të prezantohet Ungjilli, nëse njëri nga fëmijët (ose disa) shfaq interes në marrjen e një vendimi fitojni në një ambient të qetë, pa shpërqëndrime, por që është i dukshëm nga të tjerët.

Të sigurohesh se fëmija është gati për shpëtim:  
**Pyete: Mendoj që e di përse ke ardhur të flasësh me mua por, a mund të ma shprehësh me fjalët e tua?**  
Përgjigjet mund të jenë të ndryshme, si: "Dua të shkoj në qiell", "Kam mëkatuar," "E dua Jezusin," ose "Nuk e di." Nëse fëmija thotë: "Nuk e di," inkurajohet të kthehet te pjesa tjetër e nxënësve dhe mund të fisioni më vonë.

Të dalosh nëse fëmija e ka kuptuar Ungjillin:  
**Pyet: A mund të më tregosh ndonjë gjë për Librin pa Fjalë?**  
Lejoje fëmijët të të shpjegojë Ungjillin. Mos prit përsosmëri. Pritshmëria është që të ketë kuptuar mëkatin dhe nevojën për faljen e Jezusit.

Lejoje fëmijën ta personalizojë nevojën për një Shpëtimtar:  
**Pyet: A ke mëkatuar? Si ke mëkatuar?**  
Tregoj **Romakëve 3:23** në Biblën tënde.  
Nëse fëmija e mohon se ka mëkat në jetën e tij/saj, nuk është gati ta vazhdojë më tutje diskutimin. Nëse fëmija mund të të flasë për mëkatin e tij/saj dhe ta kuptojë mëkatin në mënyrë personale, mund të vazhdojë bisedën.  
**Pyete: Kush është Personi i vetëm që mund të të falë e të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit?**  
Përgjigjia: Jezusi.  
**Pyete: Përse Jezusi?**  
Përgjigjia: Sepse Jezusi është i përsosur, vetëm Ai mund të merret ndëshkimi për mëkatin duke vdekur në kryq.  
Tregoj **Hebranjëve 9:22b**.  
Pastaj, fëmija mund të vendosë emrin e vet te fjalja: "Jezusi vdiq për mëkatet e \_\_\_\_\_".

**Pyete: Çfarë ndodhi pasi Jezusi vdiq për ty?**  
Përgjigjia: Ai u ngriall, që do të thotë se Ai fitoi mbi mëkatin dhe është i gjallë sot! (1 e Korintasve 15:3b-4)

**ZBULUESIT**

Të bësh një zgjedhje personale:  
**Pyete: Çfarë do të doje që Jezusi të bënte për ty?**  
Përgjigjia mund të jetë e ndryshme: "Të heqë mëkatin tim," ose "Të marrë ndëshkimin për mëkatin tim."

**Thuaj:** Tek **Veprat 16:31** thuhet që, nëse besojmë në Zotin, Jezu Krisht (drejtoju faqes në ngjyrë të kuqe) mund të shpëtohet (faqja e zezë dhe ajo e bardhë).

**Pyete: A do të doje të luteshe dhe t'ia kërkoje Jezusit këtë?**  
Nëse thotë: "Jo," thuaj të vazhdojë të mendojë për këtë gjë gjatë javës dhe të flasë me ty javën tjetër, nëse do të dëshirojë.

Nëse thotë: "Po," thuaj: "Përse nuk lutesh dhe t'i thuash Jezusit që ke mëkatuar, që beson në Të dhe se ke nevojë që Ai të të falë mëkatet dhe të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit."

Lejoje fëmijën të lutet. Nëse ka nevojë për ndihmë me fjalët, tregoj se do ta ndihmosh, por duhet të kujtoj se po flet me Perëndinë dhe atë që thotë, duhet ta thotë nga zemra.

Siguria e shpëtimit:  
**Pas lutjes, pyete: Çfarë bëri Jezusi për ty?**  
Lejoje fëmijën të përgjigjet: Përgjigjia e tij/saj duhet të tregojë se e ka kuptuar që Jezusi e ka shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit.

**Pyete: Si e di ti këtë?**  
Përgjigjia: "Bibla më thotë kështu."


**Thuaj:** **Hebranjëve 13:5b** na mëson se kur i kërkojmë Jezusit të bëhet pjesë e jetës sonë, Ai nuk do të na braktisë kurrë. Kërkoji të vendosë emrin e tij në fjalinë: "Jezusi nuk do ta braktisë kurrë \_\_\_\_\_." Tashmë je pjesë e familjes së përjetshme të Perëndisë.

Thuaj se je i gëzuar për vendimin që ai/ajo ka marrë sot. Inkurajoje t'i tregojë dikujt tjetër për këtë vendim.

*Përshtatur nga trajnimi për shpëtimin i CEF.*

**ZBULUESIT** 09/2026


Për të ndihmuar me prezantimin e Ungjillit dhe për të filluar me dishepullimin e fëmijëve, programi i Zbuluesit ofron fletushkat *E beson apo jo?* dhe *Po tani, çfarë ndodh?*, si dhe libër shënuesin *Unë besoj*.



Fletushka *E beson apo jo?* shpjegon Ungjillin duke përdorur Shkrimin, përkufizime të përshtatshme për fëmijët dhe kornizën e Librit pa fjalë. Është një mjet i shkëlqyer për t'i shpjeguar Ungjillin një fëmijë të interesuar, dhe për t'ia dhënë me vete fëmijës që dëshiron të mendojë për ta pranuar Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tij.



Nëse një nxënës zgjedh t'i besojë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar, fletushka *Po tani, çfarë ndodh?*, është një prezantim i mirë i çfarë do të thotë të jetosh jetën e krishterë. Mbulon shkurtimisht tema si: identiteti i tyre në Krishtin, disiplina frymërore, adhurimi dhe lutja, dhe të bërët pjesë e familjes së Perëndisë.



Pasi fëmija merr vendimin t'i besojë Krishtit si Shpëtimtar, libër shënuesi *Unë besoj* mund të plotësohet si kujtesë e këtij vendimi të rëndësishëm. Shënuesin e mban nxënësi dhe pjesa fundore e tij plotësohet dhe i dorëzohet drejtuesit, në mënyrë që të gëzohemi bashkë me nxënësin.

## Tematikat dhe radha

Kurrikula e Zbuluesit është ndërtuar në bazë të tematikave dhe një radhitjeje që u mëson nxënësve një përmbledhje të Biblës çdo tri vite. Pjesa më e madhe e mësimëve fokusohen në një rrëfim specifik biblik, por tematikat dhe radhitja e tyre përfshin gjithashtu tema rastësore mësimore. Nxënësit nga klasa e 2-të deri në klasën e 5-të marrin të njëjtin mësim çdo javë.

Kurrikula ndahet në grupmoshat e mëposhtme:

- Crawlers (gjashtë muajsh) – Me program specifik
- Walkers (1 vjeçarë) – Me program specifik
- Runners (2 vjeçarë)
- Preschool (3 dhe 4 vjeçarë)
- Fillorja (kopësht – klasa e 5-të)
- Klasa e 6-të
- Koha në grupe të mëdha

Shënim: Kurrikula e DL-së përdor versionin e Biblës A.B.S. 2009

### Shënimet e drejtuesit:

- Të gjitha kurrikulat dhe burimet janë të shkarkueshme dhe të disponueshme në portalin e anëtarëve të DLGlobal.org.
- Kurrikula dhe burime të lidhura me të nxirren çdo tremujor, zakonisht një ose dy muaj para fillimit të tremujorit.
- Mësimet janë me datë dhe kishat inkurajohen t'i përmbahen programit sa më shumë të mundën. Megjithatë, programi ndryshon nga kisha në kishë dhe mund të duhen rregullime/ndryshime.
- Kurrikula jepet në formatin Word dhe mund të përshtatet sipas nevojave individuale të çdo kishe.

# Kapitulli 2

## Drejtuesit e Zbuluesit

Vullnetarët e përjavshëm dhe të mirëtrajnuar janë një pjesë thelbësore e programit “Zbuluesit”. Secila kishë ka drejtuesin e vet të programit dhe çdo grup fëmijësh ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun. Për grupmosha më të vogla se parashkollorët, ne ju inkurajojmë të keni një mësues të përjavshëm dhe ndihmës, sipas një radhe.

**Drejtuesi i zbuluesit:** Është përgjegjës për mbikqyrjen e të gjithë programit. Gjithashtu siguron udhëheqje dhe trajnim për të gjithë vullnetarët, rekrutimin e tyre, përshtatjen e kurrikulës sipas nevojës dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme.


**Drejtuesi i skuadrës:** Është përgjegjës për mbikqyrjen e kohës së shërbesës ose të grupit të vullnetarëve, duke përfshirë inkurajimin e tyre, përgjigjen e pyetjeve që mund të kenë prindërit apo vullnetarët, si dhe sigurohet që po ndiqen të gjitha politikat e shërbesës dhe gjen zëvendësuesit.

**Mësuesi kryesor:** Është përgjegjës për dhënien e mësimit nga Bibla duke tërhequr vëmendjen e nxënësve dhe duke nxitur rritjen frymërore përmes ndjekjes së programit “Zbuluesit”, dhe gjithashtu siguron udhëheqje për nxënësit e vullnetarët para fillimit të takimit.

**Drejtuesi i kohës së zbulimit:** Është përgjegjës për drejtimin e aktivitetit 15 minutësh të Kohës së zbulimit, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe me fokus punën në skuadër, siç përshkruhet në kurrikul.

**Bariu:** Është përgjegjës për inkurajimin dhe mentorimin e nxënësve gjatë takimit, përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë të ndihen të mirëpritur.

Të gjithë drejtuesit qëndrojnë gjatë gjithë mësimit duke u përfshirë me nxënësit dhe duke ndihmuar sipas nevojës. Nëse grupet janë të vogla, rolin e Drejtuesit të kohës së zbulimit dhe Bariut, mund ta bëjë i njëjti person.



Përveç pozicioneve të mësipërme, ka shumë mundësi për njerëz të tjerë që të përdorin interesat dhe dhuntitë e tyre specifike për role mbështetëse.

- **Regjistrimi:** Shënoni emrat e fëmijëve që vijnë dhe ndihmoni fëmijët e rinj të regjistrohen.
- **Skuadra e organizimit:** Organizon ambientin për kohën e aktiviteteve të Kohës së zbulimit.
- **Koordinatori i tregut të zbuluesit:** Ble mjetet e Tregut të zbuluesit, cakton vullnetarë të kasa dhe sigurohet për kursin e këmbimit.
- **Drejtuesi i adhurimit/grupit të madh:** Drejton lojën e përsëritjes para mësimit dhe adhurimin. Ndërton një skuadër që ndihmon me drejtimin e adhurimit.
- **Koordinatori i stacionit të ushqimit:** Ble dhe përgatit të gjitha aktivitetet e stacionit të ushqimit. Kujdeset për ushqimin në eventet e Zbuluesit, siç janë trajnimet.

### **Shënimet e drejtuesit:**

Përshkrimet e plota për drejtuesin e Zbuluesit, për Drejtuesin e skuadrës, për Mësuesin kryesor, për Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe për Bariun, janë të disponueshme në portalin e anëtarëve në faqen DLGlobal.org.

Programi “Zbuluesit” është projektuar duke pasur në mendje vullnetarë të përjavshëm. Ne i inkurajojmë të gjithë drejtuesit e Zbuluesit të kërkojnë vazhdimisht vullnetarë. Në rastet kur kjo nuk është e mundur, siç mund të jetë rasti kur një i rritur i vetëm merret me shërbesën, ka nevojë për vullnetarë me radhë. Dhe, në këtë rast, vullnetarët që veprojnë sipas një radhe duhet ta shohin njëri-tjetrin si skuadër, duke punuar së bashku për të dishepulluar një grup të caktuar nxënësish.

Ky model vullnetarësh siguron “udhëheqje të vazhdueshme” ose rekrutim të vazhdueshëm. Bariu është një pozicion fillestar që mentorohet përmes vëzhgimit të Drejtuesit të kohës së zbulimit dhe Mësuesit kryesor. Bariu mund të bëhet Drejtues i kohës së zbulimit dhe si Drejtuesi i kohës së zbulimit mund të bëhet Mësuesi kryesor.

### **Kualifikimet për vullnetarët**

Programi i Zbuluesit është shumë argëtues, por puna për Mbretërinë është diçka serioze! Vullnetarët kanë standarde shumë të larta dhe pritjet që secili prej tyre t'i përmbushë ato. Patjetër që askush nuk ka një jetë të përsosur, por udhëheqësit e Zbuluesit do të flasin me vullnetarin nëse shohin që ai po has vështirësi në një nga fushat e mëposhtme.

1. **Besimi në Jezu Krishtin** – Duke qenë se qëllimi kryesor i programit të Zbuluesit është të drejtojë fëmijët te Krishti dhe t'i ndihmojë më pas të rriten në jetën e krishterë, vullnetarët duhet të kenë vetë një marrëdhënie personale me Krishtin! Nëse je i pasigurt se ku qëndron në marrëdhënien me Perëndinë, të lutem fol me një pastor ose me drejtuesin e Zbuluesit. Do të jetë kënaqësi për ta të shqyrtojnë me ty Fjalën e Perëndisë dhe të të tregojnë se si të dish me siguri që je i shpëtuar dhe bir i Perëndisë. *Gjoni 3:16*
2. **Rritja frymërore** – Një dietë e shëndetshme frymërore është e nevojshme për të gjithë drejtuesit. Kontrolllo dietën tënde me pyetjet e mëposhtme: Sa kohë kam kaluar në përkushtim personal? Sa kohë kaloj duke parë televizor? Sa kohë kaloj me familjen time? Sa kohë kaloj vetëm me bashkëshortin/bashkëshorten në biseda kuptimplota? Sa kohë kaloj në lutje? A po e mësoj Fjalën e Perëndisë? *1 e Pjetrit 2:2; Efesianëve 6:13-18*
3. **Dashuria** – Shërbesa në kishë duhet të jetë e motivuar nga dashuria për fëmijët dhe Jezu Krishtin, jo nisur nga ndjesia e fajit, apo nga ndjesia e detyrimit për ta ndërtuar veten. Një përkushtim për të shërbyer te Zbuluesit duhet bërë me shqyrtim të situatës me lutje. *1 e Korintasve 13:1-3*
4. **Një shembull në karakterin e krishterë** – Si vullnetar, ti je një “akuarium”. Ti po vëzhgohesh – nga fëmijët dhe nga familjarët e tyre – edhe jashtë kishë. Vullnetarët e Zbuluesit duhet të jenë shembull dhe ndikim pozitiv për fëmijët të cilëve u shërbejnë. Duke u përmbajtur nga veprimtari që nuk e lavdërojnë dhe nuk e nderojnë Perëndinë, vullnetarët shprehin se janë të ndjeshëm ndaj bindjeve të të tjerëve si në veprime ashtu dhe në bisedat e tyre. *Titit 2:6-8, 1 Korintasve 6:18-20, Efesianëve 5:3-21*
5. **Pjesëmarrje e rregullt në kishë** – Kjo përfshin pjesëmarrjen e rregullt në shërbesa. *Hebrenjve 10:25*
6. **Inkurajues në të folur dhe në veprim** – Fjalët tona duhet të jenë inkurajuese, frymëzuese dhe pozitive. Nuk duhet të ketë fyerje, thashetheme, fjalë të pista, mënjanime ose çfarëdo të foluri që mund të lëndojë dikë, sidomos në praninë e fëmijëve. Humori duhet të reflektojë një ecje me Perëndinë. *Kolosianëve 4:6; 1 e Pjetrit 4:11*


7. **Përgatitje, dhe trajnime e zhvillime të vazhdueshme** – Shërbesa jonë ndaj Zotit duhet bërë me standardet më të larta. Vullnetarët duhet të vijnë të përgatitur çdo javë, duke e kuptuar plotësisht pyetjen: “Nëse do ta dija që Jezusi do të shfaqej fizikisht në klasën time, a do të isha i lumtur t’i tregoja Atij nxënësit në veprim?” Kjo përfshin gjithashtu pjesëmarrje besnike në takime dhe trajnime që kërkohen apo ofrohen. *2 e Timoteut 2:15; 1 e Pjetrit 4:10*
8. **Besnikë në zotimet e marra** – Kur e jep fjalën, mbaje! Nëse thua se do të bësh diçka, apo se do të jesh diku, mbaje fjalën që ke thënë! Nëse ndodh diçka dhe nuk mund të bësh atë që ke thënë, komunikojë, në mënyrë që ata të cilët preken nga ajo gjë, të mund të ndërmarrin veprimet e duhura. Nëse është e nevojshme, gjej një zëvendësues. *1 e Korintasve 4:2; Fjalët e Urta 28:20*
9. **Respektues ndaj autoritetit** – Me fjalë, veprim dhe qëndrim. Nëse ke një mosdakordësi me dikë nga skuadra apo me dikë që është në autoritet, afroju me përlësi dhe në privatësi. Respekto procedurat e kishës duke i ndjekur ato. *1 e Pjetrit 2:17*
10. **Frymë e mësueshme** – Ky është një tipar i veçantë për çdo vullnetar që po kërkon t’i shërbejë Zotit. Ne kemi dobësi, por nëse qëndrojmë të mësueshëm, ka gjithmonë shpresë! Duhet të jemi të gatshëm të dëgjojmë kritika ndërtuese dhe të konsiderojmë në lutje mendimet e të tjerëve. Nuk duhet të jemi gjithnjë dakord, por nëse nuk arrijmë të dëgjojmë, lëndojmë veten dhe heqim mundësinë për t’u rritur. *Fjalët e Urta 12:15; Fjalët e Urta 13:10; Fjalët e Urta 19:20*

# Kapitulli 3

## Pjesët përbërëse të programit

### Përmbledhje e programit të fillores

Programi i Zbuluesit për nxënësit e fillores përmban pesë pjesë përbërëse:



Këto pjesë lidhen ngushtë me njëra-tjetrën për të prodhuar një mjedis ku mësohet gjatë gjithë kohës, ku çdo minutë ka rëndësi dhe fëmijët përfshihen vazhdimisht për të mësuar pikën kryesore të mësimin ose një nga objektivat e Hartës së gjurmuesit të Zbuluesit. Programi është projektuar për një takim 1 orësh, por mund të përshtatet edhe për 45 min, apo edhe për dy orë.

## **Përmbledhja e programit “Parashkollorët”**

Discovery Land për parashkollorët përmban gjashtë pjesë përbërëse:

<b>Loja e përsëritjes para shërbesës</b>	
<b>Koha me grupin e madh</b>	
<b>Mësimi biblik</b> 	
<b>Koha e zbulimit</b>	
<b>Aktiviteti përsëritës i Kupto si duhet</b>	
<b>Aktiviteti përsëritës i Kupto si duhet</b>	
<b>ORARI I SUGJERUAR PËR PARASHKOLLORËT</b>	
5 min	Vullnetarët janë gati dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit ndërsa vijnë
15 min	Loja e përsëritjes para shërbesës
15 min	Koha me grupin e madh
20 min	Mësimi biblik
15 min	Koha e zbulimit
10 min	Aktiviteti përsëritës i Kupto si duhet
5 min	Aktiviteti përsëritës i Mendo si duhet
	Prindërit marrin fëmijët

Këto pjesë lidhen ngushtë me njëra-tjetrën për të prodhuar një mjedis ku mësohet gjatë të gjithë kohës, ku çdo minutë ka rëndësi dhe fëmijët përfshihen vazhdimisht për të mësuar pikën kryesore të mësimit ose një nga objektivat e Hartës së gjurmuesit të Zbuluesit. Programi është projektuar për një takim 1 orësh, por mund të përshtatet edhe për 45 min, apo edhe për dy orë.

## **Përmbledhje e programit “Runners”**

Discovery Land për “Runners” (dy vjeçarët), përmban shtatë pjesë përbërëse:



### **ORARI I SUGJERUAR PËR “RUNNERS”**

5 min	Vullnetarët janë gati dhe të përgatitur për të mirëpritur fëmijët ndërsa vijnë
35 min	Të vijnë në kohë
5 min	Pastrim
10 min	Koha në grupin e madh
10 min	Mësimi biblik
10 min	Punëdore apo aktivitet
5 min	Diçka për të ngrënë dhe përsëritje e mësimit
5 min	Aktiviteti përsëritës Prindërit marrin fëmijët

Këto pjesë përbërëse sigurojnë një balancë të nevojshme zhvillimore mes lojës së lirë dhe veprimtarive që i përfshijnë fëmijët të mësojnë pikën kyç të mësimit apo të një prej objektivave të Hartës së gjurmuesit të Zbuluesit për një takim rreth 1 orë, megjithatë, mund të modifikohet sipas nevojës.

### **Përmbledhja e programit të “Walkers”**

Discovery Land për Walkers (1 vjecarët) përmban shtatë pjesë përbërëse:



### **ORARI I SUGJERUAR PËR “WALKERS”**

5 min	Vullnetarët janë gati dhe të përgatitur për të mirëpritur fëmijët ndërsa arrijnë
35 min	Ardhja në orar
5 min	Të pastrojmë
10 min	Koha në grupin e madh
10 min	Mësimi biblik
10 min	Punëdore ose veprimtari
5 min	Përsëritja e mësimit dhe diçka për të ngrënë
5 min	Lojëra Prindërit marrin fëmijët

Këto pjesë janë të balancuara siç duhet për moshën, në mënyrë që të kenë edhe lojëra edhe aktivitete që i përfshijnë fëmijët për të mësuar “bazat e Biblës”. Programi është projektuar për një sesion rreth 1 orë, por mund të përshtatet sipas nevojës.

### **Përmbledhja e programit të “Crawlers”**

Discovery Land për “Crawlers” (fëmijët 6 muajsh) është një kurrikul shumë e thjeshtë 6 mujore që përqëndrohet në të mësuarit e faktit se Perëndia është Krijuesi.

## Harta e gjurmuesit

Harta e gjurmuesit është një mjet për prindërit dhe për drejtuesit e programit “Zbuluesit”, që vendos qëllime frymërore për çdo grupmoshë. Ndërsa drejtuesit rriten në përvojë dhe aftësi, ata mund të përfshijnë aftësitë e Hartës së gjurmuesit në mësimdhënie dhe në udhëheqjen e tyre.



Për shkak se nxënësit bëhen pjesë e Zbuluesit në moshë të ndryshme, ne i inkurajojmë mësuesit të përsërisin qëllimet e Hartës së gjurmuesit edhe për moshat më të vogla.

Do të vini re se ka përsëritje gjatë gjithë programit të Zbuluesit. Kjo ndodh sepse:

- Duam të nxësim nxënësit e fillores, edhe ata më të vegjël, të mësojnë përmendsh.
- Kur fëmijët e dëgjojnë diçka shumë herë, jo vetëm që e dinë dhe e kuptojnë, por edhe ua komunikojnë të tjerëve.
- Konceptet dhe informacionet në të cilat përqëndrohemi dhe të cilat i përsërisim, bëhen themel i fortë ku mund të ndërtohet ndërsa fëmijët kalojnë në 9-vjeçare dhe më tej.
- Në shumicën e shërbesave javore, fëmijët vijin vetëm 50% të kohës.

## 12 vargjet kyç të Zbuluesit

12 vargjet kyç të Zbuluesit janë të ndërthurura me kurrikulën. Vargu nga “Mendo si duhet”, shpeshherë është një nga 12 vargjet kyç.

Qëllimi i zgjedhjes së vetëm 12 vargjeve, është që fëmijët jo vetëm t'i mësojnë përmendsh ato, por gjithashtu të kuptojnë si mund t'i aplikojnë në situatat e përditshme, siç është ndarja e Ungjillit, të ndierët i frikësuar dhe sprova e besimit.

I inkurajojmë fort të gjithë drejtuesit t'i mësojnë 12 vargjet kyç që të mund t'i përmendin gjatë takimit.

### Këshilla për drejtuesin:

Mendo që kur fëmijët mësojnë 12 vargjet kyç, janë duke vendosur tulla njëra mbi tjetrën. Disa vargje mësohen te programi “Runners”, të tjerat i shtojmë te “Parashkollorët” dhe pasi nxënësit të përfundojnë programin e Zbuluesit, janë në gjendje t'i recitojnë 12 vargjet, të dinë kuptimin dhe t'i aplikojnë në jetën e tyre.

**Gjoni 14:2** – Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend.

**Romakëve 3:23** – Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë.

**Hebrenjve 9:22b** – ...dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.

**Veprat 16:31** – “Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote”.

**2 e Pjetrit 3:18a** – Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.

**Gjoni 3:16** – Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme.

**Gjoni 14:6** – Jezusi i tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.”

**Efesianëve 2:8-9** – Sepse, me anë të hirit jeni të shpëtuar, nëpërmjet besimit; dhe kjo jo prej jush, por është dhurata e Perëndisë, jo prej veprave, që askush të mos mburret.

**Fjalët e Urta 3:5-6** – Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua.

**Jozueu 1:9** – “A nuk të urdhërova unë? Ji i fortë dhe trim; mos ki frikë dhe mos u thyej, sepse Zoti, Perëndia yt, është me ty kudo që të shkosh”.

**1 e Korintasve 15:58** – Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin.

**Marku 12:30-31** – “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!”. Ky është i pari urdhërim. Dhe i dyti i ngjan këtij: “Duaje të afërmin tënd porsivetveten”. Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këto.

#### Shënimet e drejtuesit:

- Këto quhen “12 vargjet kyç të Zbuluesit”, por nuk do të thotë se ato janë vargjet më të rëndësishme apo më të mira të Shkrimit. U zgjodhën dymbëdhjetë vargje që i përshtaten kurrikulës – duke përfshirë edhe ato të pesta që përdoren te Libri pa fjalë – dhe janë të zbatueshme në jetë.
- Kur të fillojnë programin e Zbuluesit, nxënësit ka gjasa të mos i dinë përmendsh 12 vargjet. Një sfidë e familjes së gjerë të Zbuluesit është gjetja e një mënyre argëtuese për t'i inkurajuar nxënësit t'i mësojnë ato. Shih dokumentin e titulluar “T'i inkurajojmë nxënësit të mësojnë 12 vargjet kyç të Zbuluesit” në faqen e DLGlobal.org, për të marrë më shumë ide se si t'i ndihmojmë nxënësit të mësojnë përmendsh jo vetëm gjatë takimit.

## Etiketat shpërblyese dhe Tregu i zbuluesit

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit e fillores gjatë takimit dhe pastaj të shpenzohen në Tregun e zbuluesit. Ky është një sistem shpërblyes që nxënësit e Zbuluesit të mësojnë dhe të zbatojnë në mënyrë aktive Fjalën e Perëndisë ose duke fituar një sfidë gjatë aktivitetit të Kohës së zbulimit. Ky sistem është projektuar t'i ndihmojë nxënësit të ndërtojnë disiplinë të shëndetshme frymërore dhe gjithashtu e bën programin më emocionues. Barinjët inkurajohen të kenë drejtimin e shpërndarjes së Etiketave shpërblyese gjatë momenteve ku shfaqet fryti i Frymës ose ndërsa nxënësit përfshihen në mësim.

Nxënësit fitojnë mesatarisht 8 Etiketë shpërblyese në javë.

#### Kursi i këmbimit

- 3 Etiketë nëse marrin Biblat me vete (parashkollorët deri në klasën e dytë) dhe nëse përdorin Biblat (klasa e 3-të deri në klasën e 5-të)
- 2 Etiketë nëse janë aktivë gjatë pjesëmarrjes në klasë
- 1 Etiketë nëse shfaqin frytin e Frymës
- 1-5 Etiketë gjatë aktivitetit të Kohës së zbulimit (specifikuar në kurrikul)
- 5 Etiketë nëse plotësojnë Thesarin e gjurmuesit dhe rikthejnë kuponin
- 10 Etiketë për atë që vjen për herë të parë dhe për atë që e solli



#### Këshilla për drejtuesin:

- Ndiq udhëzimet specifike për përdorimin e Etiketave shpërblyese gjatë Kohës së zbulimit. Shpërblymi është pjesë e mësimin të Kohës së zbulimit. Rrallëherë do të ndodhë që çdo nxënës të marrë Etiketë shpërblyese gjatë veprimtarisë së Kohës së zbulimit.
- Nxënësit do ta vlerësojnë Etiketën shpërblyese si të ishte monedhë e vërtetë, prandaj rekomandojmë që të vendosen mënjane kur të përfundojë programi “Zbuluesit”.

Tregu i zbuluesit është një “dyqan” kur nxënësit mund të harxhojnë Etiketat shpërblyese. Zakonisht përmban lojëra apo karamelle, ose gjëra të cilat fëmijët i pëlqejnë. Çdo kishë duhet ta vendosë Tregun e zbuluesit në një mënyrë tërheqëse për nxënësit e vet, dhe që i përshtatet buxhetit.



#### Shënimet e drejtuesit:

- Disa kisha ofrojnë ëmbëlsira, disa të tjera ushqime të shëndetshme, disa vendosin edhe mjete shkollore në Tregun e zbuluesit.
- Tregu i zbuluesit është një mundësi e mirë shërbimi për nxënësit pak më të rritur apo edhe për adoleshentët.
- Koha e zbulimit mund të përdoret si një mjet i mirë dishepullimi ku nxënësve u jepet mundësia t'i harxhojnë etiketat në diçka që do të bekojë të tjerët.
- Etiketat shpërblyese janë me ngjyra, por mund të printohen edhe bardh e zi apo në fletë me ngjyra. Çdo denominacion duhet të ketë një ngjyrë dalluese, të përhershme.

## Loja e përsëritjes para shërbesës



Loja e përsëritjes para shërbesës është një mënyrë për t'i përfshirë nxënësit e fillores dhe parashkollorët që të mësojnë që prej momentit të parë që bëhen pjesë e Zbuluesit, e cila është përbërës kyç i filozofisë së të mësuarit gjatë gjithë kohës. Ajo është gjithashtu një katalizator për fëmijët që t'i inkurajojnë prindërit t'i sjellin në kohë në shërbesë.

Loja e përsëritjes para shërbesës krijon mundësinë e rishikimit të mësimit të kaluar, përsëritjes së 12 vargjeve kyç, Librit pa fjalë dhe Hartës së gjurmuesit, të cilat janë shumë të rëndësishme sepse pjesëmarrja

rrallëherë është 100%.

Loja argëtuese dhe përfshirëse duhet të luhet në grup. Për nxënësit e fillores inkurajohet edhe garimi. Për parashkollorët rekomandohet një aktivitet bashkëpunues. Një sugjerim për lojë gjendet çdo tremujor në shtojcën e kurrikulës.

#### Udhëzime për drejtuesin e Lojës së përsëritjes para shërbesës

- Mendo logjistikën e lojës paraprakisht. Sigurohu që loja të jetë e pëlqyeshme vizualisht, që të gjitha mjetet të jenë gati dhe ti të kesh një plan për ndarjen e fëmijëve në skuadra ndërsa ata vijnë.
- Planifikoji pyetjet që do të bësh. Pyetjet e përsëritjes për tremujorin gjenden në shtojcën e kurrikulës. Pyetjet mund të modifikohen dhe të shndërrohen në pyetje me alternativa apo e vërtetë/e gabuar, në mënyrë që t'u përshtaten moshës së nxënësve dhe për ta mbajtur lojën në lëvizje me ritëm të shpejtë.

- Loja e përsëritjes para shërbesës është një mënyrë e shkëlqyer për të përfshirë adoleshentët në shërbesë.

### Udhëzime për drejtuesit e tjerë të Zbuluesit

- Drejtuesit që nuk po mirëpresin nxënësit ndërsa vijnë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i inkurajojnë ata gjatë Lojës së përsëritjes para shërbesës. Nxitini!
- Sigurohuni që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpikuni t'i njihni me një mik të ri.
- Ndihmohuni të gjithë studentët të marrin pjesë dhe mbajeni lojën në lëvizje duke u dhënë herë pas here nxënësve përgjigjet e pyetjeve.

## Adhurimi

Qëllimi i kohës së adhurimit është t'u sigurojë nxënësve një mundësi për të shprehur nderim, gëzim, dashuri, adhurim dhe përnderim përmes këngës. Gjithashtu të përgatisë zemrat e tyre për mësimin e ardhshëm. Zakonisht nxënësit këndojnë dy ose tre këngë për shërbesë.



### Udhëzime për drejtuesit e adhurimit

- Adhurimi është më tepër sesa thjesht të kënduarit dhe të kërcyerit – është stil jetese!
- Përgatitjet për drejtimin e adhurimit përfshijnë leximin e mësimit të javës dhe përgatitjen e mirë për të drejtuar këngët.
- Pasioni është ngjithës! Nëse drejtuesi është plot pasion për adhurimin, do të jetë e dukshme dhe fëmijët do ta reflektojnë. Perëndia ynë i madh është një arsye për të kërcyer, bërtitur dhe kënduar!
- Drejtimi i adhurimit është një mënyrë shumë e mirë për të përfshirë adoleshentët që të drejtojnë. Me trajnim dhe inkurajim, mund të kenë ndikim të madh te fëmijët që drejtojnë.

### Udhëzime për drejtuesit e tjerë të Zbuluesit

- Inkurajohuni nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet dhe/ose thjesht duke qëndruar në këmbë në shenjë respekti.
- Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe korrigjojnë çdo sjellje shqetësuese.

### Shënimet e drejtuesit:

- Këngët e sugjeruara gjenden te shtojca e çdo tremujori të kurrikulës. Secila këngë përfshin edhe një deklaratë të shkurtër që e lidh me fokusin e mësimit.
- Ka këngë të ndryshme për grupmoshat e ndryshme.
- Video me veprime dhe video me trajnime të shkurtra për drejtuesin e adhurimit gjenden në faqen e internetit.
- Edhe pse ka sugjerime këngësh, adhurimi përmes muzikës është shumë kulturor dhe mund të ndryshojë bazuar në vendndodhjen dhe historinë e kishës. Përdor këngët e sugjeruara ose zgjidh këngë të tjera që do t'i nxisin fëmijët të adhurojnë Perëndinë.
- Deklaratat e përfshira me këngët e sugjeruara mund të përshtaten, sipas nevojës, me këngët që do të zgjidhni.

## Hapja e takimit me grupin e madh të parashkollorëve

Përveç lojës së përsëritjes para shërbesës dhe këngëve të adhurimit, hapja e takimit me grupin e madh të parashkollorëve përfshin gjithashtu:

- Prezantimin me konceptin e të dhjetës dhe mundësisë së fëmijëve për të dhënë.
- Prezantimin me mësimin e ditës përmes një teatri me kukulla. Teatri është gjithmonë një dialog mes drejtuesit të grupit të madh dhe devesë Gjurmuesi, ose motrës së tij, Kami deveja. Janë e njëjta kukull; për t'u dukur si Kami, mund t'i vendoset një fjongo në kokë. Ka disa raste, gjatë periudhës së Pashkës, kur mund të shfaqet një gomar.
- Mësimi i 12 vargjeve kyç përmes përsëritjes dhe lëvizjes së duarve. Parashkollorët do të mësojnë 12 vargjet kyç gjatë kohës së shërbesës.

### Shënimet e drejtuesit:

- Për t'u përgatitur për teatrin me kukulla do të keni nevojë për gjërat e mëposhme:
- Skenë e thjeshtë teatri – mund të keni një skenë fikse, ose diçka të thjeshtë si çarçaf të lidhur në të dy cepat.
- Një kukull për teatrin.
- Një kuti ku të mbani mjetet.

## Koha e zbulimit (KZ)



Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë projektuar për t'i përfshirë nxënësit e fillores dhe parashkollorët, gjithashtu për t'i sfiduar ata përmes të mësuarit aktiv. Gjatë KZ-së, ata do të përjetojnë një reagim apo emocion që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin biblik. Në disa raste, KZ-ja do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mësimit biblik për nxënësit, siç mund të jetë ndjesia, aroma apo shija e diçkaje në rrëfimin biblik.

Një aktivitet i KZ-së mund të përshkruhet edhe si mësim i prekshëm – një mësim në të cilin fëmijët mund të marrin pjesë! Nxënësit e duan shumë Kohën e zbulimit dhe e mbajnë mend atë.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve të KZ-së përdorin metoda dhe objekte që fëmijët kanë pëlqyer në të shkuarën dhe do të vazhdojnë t'i pëlqejnë në të ardhmen si rëra, uji, legot dhe rrugët me pengesa.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme të kuptojmë dhe kujtojmë qëllimin e KZ-së dhe se si lidhet me mësimin. Nëse drejtuesi nuk e ka kuptuar lidhjen, KZ-ja do të jetë aktivitet argëtues, por i pakuptimtë.

Për nxënësit e fillores, KZ-ja shpesh përfshin konkurrencë për ta mbajtur aktivitetin argëtues dhe përfshirës. Kjo do të thotë se do të ketë edhe fitues edhe humbës. Është e rëndësishme që jo të gjithë të fitojnë. Edhe pse po të fitojnë të gjithë, duket sikur je i mirë me të gjithë, kjo gjë u tregon atyre se aktiviteti dhe rezultatet nuk kanë vërtet rëndësi. Ata nuk do t'u besojnë udhëzimeve në të ardhmen dhe gjithashtu mund të dobësohet lidhja mes KZ-së dhe mësimi.

## Udhëzimet për drejtuesit e KZ-së

- Lexojeni të gjithë mësimin e javës, kuptoni qëllimin e KZ-së dhe se si ajo lidhet me mësimin.
- Mendoni hapat dhe proceset e KZ-së. Kaloni të gjithë aktivitetin në mendje dhe planifikoni si do ta ndiqni. Bëjini vetes këto pyetje:
  - ✓ Çfarë do të të duhet të bëni për t'u siguruar se aktiviteti do të jetë i thjeshtë, argëtues dhe përfshirës?
  - ✓ Si do t'i ndani nxënësit në skuadra pa humbur kohë?
  - ✓ Si do t'u jepni udhëzimet? Do të përdorni diagramë apo foto?
  - ✓ A do të keni nevojë për Mësuesin kryesor dhe Bariun?
  - ✓ Si do t'ua komunikoni rregullat nxënësve?
  - ✓ Si do të mbeteni entuziast gjatë aktivitetit?
  - ✓ Si do ta merrni dhe do ta mbani vëmendjen e tyre?
- Sigurojini që e keni kuptuar si ta ndërthurni pikën "Vepro si duhet" me aktivitetin. Zakonisht funksionon përsëritja e një fjale apo fraze.
- Kini pritshmërinë se do të jetë aktivitet argëtues dhe edukativ!
- Qëndrojeni udhëzimeve të kurrikulës për fituesit dhe për humbësit.

### Këshillë

#### për drejtuesin:

Për t'i ndarë nxënësit në skuadra pa humbur kohë, vendosi nga një numër në dorë ose një ngjyrë tek etiketa e emrit kur të vijë për takimin.

## Udhëzime për Mësuesin kryesor

- Trego kujdes ndaj reagimeve dhe emocioneve të nxënësve gjatë KZ-së. Kjo do të jetë e dobishme për ndërthurjen e KZ-së gjatë mëimit.
- Ndhmo drejtuesin e KZ-së dhe nxënësit sipas nevojës.

## Udhëzime për Bariun

- Ndhmo drejtuesin e KZ-së dhe nxënësit sipas nevojës.
- Tregohu i kujdesshëm ndaj nxënësve që janë për herë të parë dhe nuk e kuptojnë KZ-në.

## Ndryshimi mes KZ-së për nxënësit e fillores dhe për parashkollorët:

Koha e zbulimit për parashkollorët është e ngjashme me atë për nxënësit e fillores. Megjithatë, ka disa ndryshime, sepse parashkollorët zakonisht nuk janë shumë konkurrues dhe duan aktivitete të thjeshta dhe të kuptueshme. Për të pasur një kohë më të suksesshme me parashkollorët në KZ:

- KZ-ja të jetë bashkëpunuese dhe jo konkurruese. Te parashkollorët garojmë pa theksuar fitues.
- Përpiqemi të japim vetëm një, ose më së shumti dy udhëzime njëherësh.
- Jemi shumë pozitivë dhe inkurajues.
- Nëse është e mundur, le të japim një shembull të asaj që duhet të bëjnë. Ndoshta mund ta bëjmë aktivitetin me Mësuesin kryesor dhe Bariun, në mënyrë që fëmijët ta shohin.
- Rishqyrtojmë pritshmëritë e sjelljes – nxënësit duhet të binden, sepse po argëtohen.
- KZ-ja zhvillohet pas mëimit biblik që të mund të përforcojmë pikën "Vepro si duhet".

## Shënimet e drejtuesit:

- KZ-ja mund të përshtatet sipas materialeve dhe hapësirës që keni në dispozicion. Nëse ju duhen ide apo ndihmë për të kuptuar se si të përshtasni disa nga aktivitetet e KZ-së, kontaktoni këshilluesin tuaj nga "Discovery Land Global".
- Mjetet dhe hapësirat e KZ-së janë mjete për të mësuar, jo lodra. Ruajini ato vetëm për qëllime mësimore. Nëse fëmijët do të luajnë me mjetet e KZ-së në momente të tjera, ato nuk do të jenë më argëtuese gjatë Kohës së zbulimit. Vlera e atyre objekteve do të bjerë shumë nëse përdoren jashtë KZ-së.
- Vendosini mjeteve dhe hapësirave të KZ-së etiketa për të treguar se shërbejnë si mjete mësimore. Për shembull, merrni dhe vendosni një etiketë në një dollap apo kosh ku shkruhet: "Mjetet mësimore për Kohën e zbulimit".

## Mësimi biblik

Qëllimi i mëimit biblik në klasë është t'i sfidojë fëmijët të njohin dhe të studiojnë Fjalën e Perëndisë. Mësimet janë projektuar për një orë mësimore të drejtuar nga një mësues. Mësuesi ka privilegjin ta bëjë Biblën të gjallë përmes veprimeve e mëimit krijues dhe jo thjesht duke përdorur fletët e mëimit.

Nxënësit janë pjesëmarrës aktivë në mësim. Nxënësit e fillores marrin dhe përdorin Biblat e tyre çdo javë, duke gjetur pjesët nga Shkrimi që përmenden të mësimi. Mësuesi gjithashtu e përfshin Kronologjinë e Biblës për t'i mësuar nxënësit të kuptojnë pamjen e madhe të planit shpengues të Perëndisë. Nxënësit gjithashtu marrin pjesë përmes përsëritjes që gjendet në çdo mësim.

### Mësuesi kryesor duhet fillimisht t'i njohë nxënësit e vet

- Është përgjegjësia e Mësuesit kryesor të masë “temperaturën frymërore” të nxënësve të vet, duke përfshirë këtu faktin nëse ata kanë besuar ose jo në Krishtin si Shpëtimtarin e tyre. Një mënyrë e thjeshtë për të kuptuar se në ç'pikë ndodhen nxënësit frymërisht është t'u kërkojë të pohojnë me gishtin e madh nëse janë të sigurt që i kanë kërkuar Jezusit të jetë Zoti dhe Shpëtimtari i tyre, dhe të mohojnë me gishtin e madh nëse janë të pasigurt.
- Është gjithashtu e rëndësishme që mësuesi kryesor të kuptojë kulturën në të cilën jetojnë nxënësit çdo ditë, në mënyrë që ta ketë më të lehtë të përfshijë shembuj nga jeta reale në mësim. Disa mënyra për t'i kuptuar nxënësit më mirë janë:
  - Shih programe televizive që ata ndjekin.
  - Pyeti se çfarë muzike dëgjojnë.
  - Pyeti se çfarë lloj pajisjesh përdorin dhe cilat aplikacione kanë në to.
  - Flit me prindërit: me cilat vështirësi përballen fëmijët e tyre?
  - Në cilat aktivitete jashtëshkollore përfshihen?
  - Kur vijnë në klasë, pyeti si ka shkuar java.
  - Fol me një mësues shkolle për të mësuar si është një ditë e zakonshme në shkollë.

### Plani i mëimit biblik

1. Numri i mëimit, data dhe referenca nga Shkrimi
2. Katër pikat e të mësuarit si duhet
3. Aktivitetet e Kohës së zbulimit
4. Përgatitje për mësimin
5. Prezantimi i mëimit
6. Përmbledhja e mëimit
7. Pyetjet e përsëritjes

#### Këshilla për drejtuesin:

Në një kulturë ku Bibla shpeshherë konsiderohet vepër e trilluar, shmange fjalën “histori” kur i referohesh pjesës së Shkrimit që po studiojmë. Frazat që mund të përdorësh në vend të saj janë: “rrëfim biblik” ose “mësim biblik”.

### **Përgatitje e mësimit biblik**

Përgatitja që zakonisht duhet për të dhënë një mësım efektiv dhe me kreativitet është 2-3 orë.

1. **Lutu:** Lutu për drejtimin e Perëndisë ndërsa lexon Shkrimin dhe përmbledhjen e mësimit. Lutu që Perëndia të ta përgatisë zemrën për të qenë e hapur për të vërtetën e Fjalës së Perëndisë. Lutu edhe për nxënësit e tu. Kërkoji Perëndisë të të sjellë në mendje nxënës specifikë dhe mënyra se si ky mësım mund të ketë ndikim te ta.
2. **Lexo Biblën:** Lexo të gjithë pjesën nga Shkrimin që mbulon mësimi. Vetëm Fjala e Perëndisë është e pagabueshme.
3. **Fillo duke pasur përfundimin në mendje:** Lexo katër pikat e të mësuarit si duhet dhe pyetjet e përsëritjes.
4. **Lexo të gjithë mësimin në kurrikul.**
5. **Rishiko kalimin nga KZ-ja te mësimi:** Sigurohu ta kesh kuptuar lidhjen mes KZ-së dhe mësimit.
6. **Lexo edhe njëherë të gjithë mësimin:** Mbaj shënime, shëno idetë kryesore dhe vendos se si do të përfshish ide krijuese për mësimin. Gjej se ku ndahet Ungjilli në mësım dhe sigurohu të rishikosh Librin pa fjalë. Gjej gjithashtu vende në kurrikul ku mund të tregohesh krijues:
  - Një moment ku mund të shfaqësh një foto.
  - Një moment ku nxënësit mund t'i përgjigjen një pyetjeje.
  - Shkruaj pyetje ose nënvizo pyetjet që bëhen në kurrikul.
  - Gjej një moment në kurrikul ku mund të theksosh pikat e të mësuarit si duhet ose ku mund të përmendësh KZ-në.
  - Rishiko ndryshimin mes 'parafrazimit' dhe 'përmbledhjes'.
  - Nënvizo pikat kyç.
7. **Bëj gati mjetet që mund të të duhen.**

**SHËNIM:** Mësuesit duhet t'i mbajnë të hapura Biblat gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë se ngjarja vjen nga Bibla. Për shkak të kufizimit të kohës dhe për shkak të vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga vetë nxënësit, mësimi nuk duhet lexuar nga ndonjë libër tjetër me histori biblike.

## Mësimdhënia në klasë

Secili mësim biblik për nxënësit e fillores ndjek të njëjtin format. *Shënim: për parashkollorët, formati është paksa ndryshe.*



## **Lidhja e mësimit me KZ-në**

Nxënësit mund të hutohen ndërsa kalojnë nga KZ-ja në mësim. Përgatitu për këtë kalim duke e bërë menjëherë lidhjen mes mësimit dhe KZ-së.

Kurrikula shpjegon se si lidhet KZ-ja me mësimin biblik në seksionin “Lidhja e KZ-së me mësimin”. Sigurohu që ta kesh kuptuar dhe të mund ta shpjegosh qartë lidhjen, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë se nuk ishte thjesht një aktivitet argëtues.

## Lutja në klasë

Inkurajo nxërin nga nxënësit të lutet në fillim të mësimit. Kjo i ndihmon ata të përqëndrohen te Perëndia, i mëson të luten dhe inkurajon aftësitë udhëheqëse frymërore. Kjo kohë mund të përdoret për t'i mësuar nxënësit:

- Rreth nderimit të Perëndisë – përse bashkojmë duart dhe mbyllim sytë.
- Që Perëndia dëgjon secilin prej nesh dhe i pëlqen që ne të flasim me Të.
- Që Perëndia u përgjigjet lutjeve në tri mënyra: “Po”, “Jo” dhe “Prit”.
- Se si lutja bashkon trupin e Krishtit.
- T'i luten Perëndisë me besim dhe me zë të lartë në grupe të vogla dhe të mëdha.

## Zbuloje dhe Kronologjia

Duhet t'i inkurajojmë nxënësit t'i marrin Biblat me vete çdo javë. Qëllimi ynë është që ata të kuptojnë si funksionon Bibla, si ta përdorin atë dhe se si mësimi i ditës përfshihet në kronologjinë e planit të Perëndisë. Këtë e quajmë koha e “zbulimit”, sepse nxënësit do të gjejnë mësimin në Biblat e tyre dhe te kronologjia.

### Zbulo: Dhiata e Vjetër apo e Re dhe referenca nga Shkrimi

Nxënësit duhet të gjejnë vargun në Biblën e tyre. Qëllimi është që nxënësit të mund ta shfletojnë Biblën duke ditur ku gjenden librat, gjë që do t'i ndihmojë në përgatitjen për të lexuar vetëm.

### Kronologjia

Përdorimi i kronologjisë i ndihmon nxënësit të shohin se Perëndia kishte, dhe ende ka, një plan për secilin prej nesh. Zbuloni se në cilën kohë të historisë ndodh ngjarja e mësimit duke përdorur kronologjinë. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë se si mësimi i ditës përfshihet në planin e madh shpengues të Perëndisë. Kjo gjithashtu i ndihmon ata të kuptojnë kalimet që bëjmë mes Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re.

## Prezantimi me mësimin biblik

Te “Prezantimi me mësimin” janë disa fjali të thjeshta që ndihmojnë në tërheqjen e vëmendjes së nxënësve. Ky prezantim bën gjithashtu lidhjen mes mësimit të ditës dhe mësimit të kaluar.

### **Këshilla për mësuesin:**

Lidhja me KZ-në, lutja në klasë dhe seksioni “Zbuloje”, duhet të marrin vetëm 2-5 minuta.

Shmange leximin me zë të lartë nga fëmijët. Për shumë prej tyre mund të shkaktojë ankth, ata do të përqëndrohen vetëm te fjalët që duhet të lexojnë dhe disa të tjerë nuk do të kuptojnë.

### **Përmbledhja e Shkrimit**

Ka një përmbledhje të Shkrimit që ndihmon në drejtimin e mësimit:

**Përmbledhja e vargjeve:** Kjo bëhet vetëm për mësuesin (jo për dialog).

**Lexo:** Pjesën nga Shkrimi që duhet lexuar me zë të lartë para nxënësve.

**Përmbledhje:** Pas leximit të pjesës nga Shkrimi, merr kohë për të shpjeguar kuptimin. “Përmbledhja” shpesh përmban një pyetje, një fjalë kyç ose riprezanton pamjen e madhe të asaj që u lexua për nivelin e fëmijës.

**Parafrazimi:** Këtë pjesë nuk duhet ta lexosh nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet bërë më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexo tekstin e parafrazuar fjalë për fjalë nga kurrikula përpara fëmijëve.


## Përfundime

Përfundoje mësimin duke i përqëndruar nxënësit te pikat: Kupto, Mendo, Vepro dhe Ndihu si duhet. Ky është momenti për t'i sfiduar nxënësit të veprojnë si duhet në situatat e përditshme me të cilat përballen.

## Burime shtesë për mësimin

Materialet e mëposhtme mësimore janë në dispozicion për ju:

- Kronologjia biblike: Kronologjia biblike përfshin shumë nga rrëfimet në programin tre vjeçar. Ajo ndahet në dy seksione: Dhiata e Vjetër (ngjyrë vishnjë) dhe Dhiata e Re (ngjyrë e artë). Të dyja lidhen nga një foto që lexon “400 vite heshtje”. Fotoja “Epoka e kishës” i ndihmon nxënësit të kuptojnë se ku qëndron jeta e tyre në këtë kronologji.
- 12 vargjet kyç të Zbuluesit: 12 postera të printueshëm për t'u vënë në mur.
- Posterat e librave të Dhiatës së Vjetër dhe të Re: Këto përdoren gjatë seksionit “Zbulojë” në mësim.
- Etiketat shpërblyese
- Poster “Ndihi si duhet”: Ky poster përdoret për të theksuar ndjenjat e ndryshme që njerëzit mund të kenë pasur në rrëfimin biblik dhe gjithashtu shërben për ta lidhur nxënësin me momentet e seksionit “Ndihi si duhet” në mësim.
- Harta e kohës biblike: harta përfshin vendndodhjen e shumë rrëfimeve biblike.
- Tabelë: ide për përdorimin e tabelës jepen çdo tremujor në kurrikul.



Materialet e mëposhtme janë në dispozicion për çdo orë mësimore. Një përshkrim i tyre gjendet në seksionin “Librin pa fjalë – ndarja e Ungjillit” në manual.

- Libri pa fjalë
- Fletushka “E beson apo jo?”
- Libërshënuesi “Unë besoj”
- Fletushka “Çfarë ndodh më pas?”
- Kartat “T”i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit”



### Shënimet e drejtuesit:

Përveçse kemi vënë në dispozicion materialet e mësipërme për mësuesit, ne rekomandojmë krijimin e një grupi materialesh për ta, që përfshin disa nga mjetet më të përdorshme si: batanije, arka thesari, kurora dhe kostume të kohës së Biblës. Materialet mund të vendosen në një dollap apo raft. Zgjidhni disa materiale kyç dhe kërkoni për dhurime. Dikush mund t'i ketë ato gjëra edhe në shtëpi dhe nuk i përdor! Pastaj organizoni një sistem përdorimi të thjeshtë. Kujtoju mësuesve që materialet janë në dispozicion dhe inkujajoji t'i përdorin për ta bërë Biblën të gjallë për fëmijët!

## Loja e fundit e përsëritjes (për filloren)

Loja e fundit e përsëritjes për nxënësit e fillores gjendet te shtojca e kurrikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjët drejtojnë lojën e përsëritjes ndërkohë që prindërit vijnë për t'i marrë fëmijët, ndërsa Mësuesi kryesor shpërmdan Etiketat shpërblyese dhe bisedon me prindërit.

### Këshilla për drejtuesin

Jep shpërblim për pyetjet e përsëritjes, shndërroji në pyetje 'e vërtetë/e gabuar', ose ofroji si pyetje me alternativa për t'iu përshtatur nivelit të moshës së nxënësve. Qëllimi është të rishikohen dhe përforcohen njohuritë.

### Loja e përsëritjes është e rëndësishme sepse:

- përforcon mësimin e dhënë gjatë takimit.
- ndihmon mësuesin të vlerësojë nëse mësimdhënia ka qenë efektive.
- përsërit pyetje dhe përgjigje disa herë; përsëritja është thelbësore që nxënësit të mbajnë mend dhe do t'i ndihmojë ata ta ruajnë informacionin që kanë marrë.
- i ndihmon nxënësit të vënë në zbatim atë që kanë mësuar gjatë javës.
- mundëson të mësuarit gjatë gjithë kohës. Ne çmojmë çdo minutë që kemi me nxënësit tanë dhe për këtë arsye i mësojmë që prej momentit që hyjnë derisa dalin.
- u tregon prindërve se koha që fëmijët e tyre kalojnë te Zbuluesit është e vlefshme dhe e kalojmë duke mësuar Fjalën e Perëndisë.
- krijon një eksperiencë pozitive përfundimtare për nxënësit.

### Udhëzime për Mësuesin kryesor

- Qëndro te dera dhe bisedo me prindërit.
- Shpërndaj Thesaret e gjurmuesit dhe inkurajoj prindërit t'i plotësojnë me fëmijën gjatë javës.
- Dëgjo me vëmendje Lojën e përsëritjes për të vlerësuar se çfarë kanë mësuar nxënësit.

### Udhëzime për drejtuesin e Kohës së zbulimit

- Drejto lojën e fundit të përsëritjes.

### Udhëzime për Bariun

- Ndihmo drejtuesin e Kohës së zbulimit në lojën e fundit të përsëritjes, sipas nevojës.
- Ndihmoji nxënësit të mbledhin gjërat e tyre.
- Shpërndaj Etiketat shpërblyese.

## Aktivitetet e “Kupto si duhet” dhe “Mendo si duhet” (Parashkollorët)

Mësimi i parashkollorëve përfundon me aktivitete të thjeshta për “Kupto si duhet” dhe “Mendo si duhet”. Aktiviteti i “Kupto si duhet” përsërit përmbajtjen e mësimin. Aktiviteti i “Mendo si duhet”, që përsërit vargun nga Shkrimi, udhëhiqet nga drejtuesi i Kohës së Zbulimit dhe/ose Bariu ndërsa fëmijët bëhen gati të largohen, ndërkohë që Mësuesi kryesor shpërmdan Gjurmuesin Junior dhe bisedon me prindërit.

### Këshillat e drejtuesit:

Riformuloji pyetjet e përsëritjes, shndërroji në 'E vërtetë/E gabuar' ose në pyetje me alternativa, sido që të përshtatet më mirë me nivelin e moshës. Qëllimi është të përsëritet dhe të përforcohet të kuptuarit.

## Testimi

Çdo pranverë, programi i Zbuluesit përmban një ditë testimi për nxënësit e fillores. Testimi ka si funksion të ndihmojë udhëheqësinë, mësuesit dhe prindërit që të kuptojnë më mirë se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe se si po rriten ata frymërisht. Qëllimi ynë është t'i sfidojmë fëmijët të bëhen kampionë frymërorë – fëmijë që e njohin dhe e aplikojnë në mënyrë të efektshme Fjalën e Perëndisë në jetën e tyre. Testimi ndihmon në të kuptuarit më të thellë se si mund t'u shërbejmë më mirë prindërve dhe fëmijëve për të arritur qëllimin.

Fjala “test” mund t'i shqetësojë pak njerëzit kur bëhet fjalë për kishën dhe fëmijët. Megjithatë, një komunikim i qartë, i hapur dhe pozitiv me prindërit, fëmijët dhe (kur është e nevojshme) me udhëheqësinë e kishës rreth qëllimit të testimit, mund të lehtësojë shqetësimin.

### Shënimet e drejtuesit:

#### Parashkollorë – Klasën e 1-rë:

Testimi i parashkollorëve dhe klasës së parë do të mundësojë krijimin e një pamjeje të përgjithshme të pikës ku kanë arritur nxënësit nga ana frymërore. Nxënësit sfidohen që të mendojnë, procesojnë dhe të përdorin atë që kanë studiuar gjatë vitit.

#### Klasa e 2-të – Klasën e 5-të

Për testimin e nxënësve në këto klasa rekomandohen pikat e mëposhtme:

Vendosni pikë për testimin, në mënyrë që të mund të masni përmirësimin në të ardhmen.

Shënoni pikat e forta dhe fushat e rritjes.

Dërgojani rezultatet prindërve bashkë me fletën e përgjigjeve. Nëse një nxënës shkëlqen në test, vendosi një notë apo përqindje në fletë bashkë me një shënim inkurajues. Nëse fëmija nuk del mirë në test, mos shëno as përqindje as notë, dhe mos e mbush fletën me kryqe të kuqe. Nëse i jepni prindërve edhe fletën e përgjigjeve të sakta, ata do të kuptojnë se çfarë u mësojmë në programin e Zbuluesit dhe në ç'pikë është fëmija i tyre.

Përdorni rezultatet e testeve për të mprehur drejtuesit. Rezultatet e testeve mund të na ndihmojnë që të planifikojmë trajnime strategjike në të ardhmen.

#### Këshilla për testimin:

Krijoni një grup të veçantë vizitorësh për nxënësit e rinj dhe vizitorët që janë për herë të parë. Rishiko fletushkën “E beson apo jo?”, tregojni klasat, shpjegoni Etiketat shpërblyese, dhe/ose shih një video gjatë kësaj kohe.

Bëje testimin argëtues! Sill diçka për të ngrënë në fund të testit ose jepni nxënësve lapsa me figura që mund t'i marrin me vete në shtëpi pas testit.

Për nxënësit e klasave 2-5, ky do të jetë një test bibliik i mbyllur. Mbuloni posterat në mur që të mos i tundoni nxënësit të kopjojnë, ose thjesht zhvendosini në korridor.

Nëse disa nxënës kanë vështirësi në lexim, inkurajo një Bari t'i ndihmojë në korridor duke thënë: “Do të kemi dy zona testimi. Nëse dëshironi t'ua lexojmë testin, mund të uleni në korridor. Nëse preferoni të punoni në qetësi, mund të qëndroni në klasë.”

Ulini nxënësit në rreshta që të mos kopjojnë. (klasat 2-5)

Mos lajmëroni për testin një javë para. Ndoshta disa prindër mund të mos i sjellin fëmijët atë ditë.

Nëse ju mbetet kohë shtesë pas përfundimit të testit, luani një lojë argëtuese për përsëritje.

## Një mjedis i gëzueshëm dhe efektiv për mësimin

Një shërbesë efektive e Zbuluesit përfshin krijimin e një mjedisi që është i gëzueshëm dhe i favorshëm për të mësuar. Të gjithë drejtuesit e Zbuluesit kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e këtij mjedisi, dhe fokusi duhet të jetë në parandalimin e çështjeve të disiplinimit. Disa parime të rëndësishme:

**Lutja** – Lutu për çdo student me emër. Lutu që të vijnë me zemrat dhe mendjet e përgatitura për të mësuar. Lutu specifikisht për ata që kanë sfida në sjellje.

**Fokusohu** – Kupto pikësynimin. Mëso pikat e: “Kupto, Mendo, Vepro dhe Ndiu si duhet”. Mendo për mënyra specifike se si secili nxënës mund të rritet frymërisht.

**Përgatitja** – Nëse nuk ke një plan për fëmijët, ata do të kenë një plan për ty! Ji plotësisht i përgatitur përpara se të arrish, që të mund t’u japësh vëmendje të plotë nxënësve. Planifikoje kohën nga fillimi në fund. Përgatit edhe një plan rezervë në rast se mësimi përfundon herët, nëse zgjatet shërbesa etj. Kushtoj rëndësi të veçantë momenteve kur kalohet nga një seksion në tjetrin, sepse zakonisht aty shfaqen problemet në sjellje. Ato momente mund t’i përdorësh për të ndërtuar marrëdhëniet, për të praktikuar vargun e “Mendo si duhet” etj.

**Aspektet fizike** – Në momentet që është e mundur, krijo një mjedis fizik që i ndihmon nxënësit të përqendrohen. Nëse diçka bëhet shpërqendrim, largoje. Rrethoju ambientet në të cilat nxënësit nuk duhet të hyjnë. Mund të vendosësh një shirit apo diçka tjetër, që u tregon nxënësve se ku duhet të qëndrojnë apo të ulen.

**Pritshmëritë** – Cakto dhe trego qartësisht disa pritshmëri të thjeshta për sjelljen e tyre. Qëndrueshmëria është çelsi. Këto pritshmëri duhet të jenë të qëndrueshme edhe te drejtuesit edhe te shërbesat e tjera.

**Marrëdhëniet** – Ndërtimi i marrëdhënieve me fëmijët i ndihmon të ndihen të dashur, të sigurt dhe të pranuar. I ndihmon ata të respektojnë dhe t’i përgjigjen udhëheqësisë sate. Koha që kalojmë te Zbuluesit është e kufizuar dhe përqendrohet në mësimin e Fjalës së Perëndisë. Megjithatë, ka mënyra se si mund t’i ndërtosh marrëdhëniet:

- Përdor emrat e tyre.
- Përdor hapësirat e lira për të folur me fëmijët.
- Bëj pyetje që u japin mundësi të shprehin mendimin e tyre.
- Kupto çfarë është e rëndësishme për ta.
- Njihu me ta si një drejtues që kujdeset, jo si mik.
- Fol me ta edhe pas përfundimit të mësimin – ji me fëmijët edhe atje ku ata janë.
- Fol mirë për ta përpara prindërve.
- Kujto se qëllimi yt nuk është modifikimi i sjelljes – ne nuk prodhojmë robotë; ne dëshirojmë të shohim transformimin e vërtetë të zemrës dhe jetës së tyre.

**Ngazëllimi** – Fëmijët ndjekin shembullin tënd. Nëse ty të ngazëllon Fjala e Perëndisë, ka më shumë gjasa që edhe ata t’i ngazëllojë. Nëse ti je i shpërqendruar dhe i mërziur, ka më tepër gjasa që ata të jenë të shpërqendruar dhe të mërziur, gjë e cila më pas çon në problematika në sjelljen e tyre.

**Ripërqendrimi** – Numërimi deri në 5 është një mënyrë e mirë për ta ripërqendruar grupin e fëmijëve. Njëri prej drejtuesve numëron me zë të lartë dhe ngadalë deri në pesë, duke treguar numrat me gishtat e dorës. Nxënësit duhet të jenë qetësuar para se drejtuesi të arrijë te numri “pesë”. Është shumë e rëndësishme qëndrueshmëria në përdorimin e numërimit deri në 5.

# Kapitulli 4

## Lidhja me familjet, inkurajimi dhe pajisja e prindërve

Është thelbësor krijimi i një lidhjeje të fortë mes kishës dhe shtëpisë. Kisha duhet të punojë vazhdimisht për të inkurajuar dhe pajisur prindërit që të jenë drejtues frymërorë në shtëpinë e tyre.

- Te Ligji i Përtërirë 6, Perëndia urdhëron popullin e Tij t'u mësojë fëmijëve Fjalën e Tij.
- Tek Isaia 38:19b, ne shohim se një brez mëson për besnikërinë e Perëndisë nga brezi paraardhës.
- Dhiata e Re jep udhëzime për marrëdhënien e prindit me fëmijët, duke treguar se kjo marrëdhënie është e rëndësishme për Perëndinë.

Bibla na jep shembuj të fëmijëve që u mësuan nga prindërit dhe gjyshërit e tyre:

- Timoteu u mësua nga nëna dhe gjyshja e tij (2 e Timoteut 1:5)
- Etërve të kishës në Efes u qe thënë të mësonin fëmijët e tyre në Zotin (Efesianëve 6:5)

Drejtuesit e Zbuluesit kanë rreth 52 orë në vit me fëmijët NËSE ata marrin pjesë çdo javë. Prindërit kanë shumë më tepër kohë se aq dhe ata kanë mundësinë për t'u mësuar fëmijëve të tyre se si ta zbatojnë Fjalën e Perëndisë në jetën e përditshme.

Mund t'i inkurajojmë prindërit që:

- Të marrin pjesë rregullisht në kishë ose në programin e Zbuluesit (Hebrenjve 10:25).
- T'u mësojnë vazhdimisht fëmijëve Fjalën e Perëndisë dhe pastaj ta përsërisin e përforcojnë në përditshmëri (Kolosianëve 3:16).
- T'i përfshijnë fëmijët që t'i shërbejnë Perëndisë në shtëpitë dhe komunitetet e tyre (Efesianëve 4:12).

## Thesaret e gjurmuesit dhe Gjurmuesi Junior

Thesaret e gjurmuesit (për filloren) dhe Gjurmuesi Junior (për parashkollorët) janë shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët që t'i marrin me vete në shtëpi. Është një mjet i rëndësishëm që e përdorim për të bashkëpunuar me prindërit.

Përdorimi i këtij materiali do t'i ndihmojë prindërit që:

- Të prezantojnë koncepte frymërore kyç dhe biblike si: dashuria e Perëndisë, mëkati, ndëshkimi (të cilin Jezusi e mori për ne), vendimet e drejta dhe e vërteta.
- Të kenë biseda frymërore në shtëpi. Sfidat e familjes japin motivim dhe ide që prindërit të përfshihen me fëmijët e tyre për konceptet në mësimin e radhës nga programi "Zbuluesit".
- T'i sfidojnë fëmijët e tyre të mendojnë dhe zbatojnë pikat "Kupto, Mendo, Vepro dhe Ndihi si duhet" në situata reale.



I nxisim mësuesit t'ua japin prindërve këto materiale çdo javë duke i inkurajuar t'i plotësojnë me fëmijën. Te secila prej tyre ka një kupon që nxënësit mund ta kthejnë dhe të marrin Etiketa shpërblyese (për filloren) ose çmime të vogla (për parashkollorët).

Fëmijët e kurrikulës së "Runners" plotësojnë një projekt apo aktivitete që e marrin me vete në shtëpi çdo javë, në mënyrë që prindi të kuptojë se çfarë ka mësuar fëmija.

**Këshilla për drejtuesit e fillores:**

Herë pas here krijoni "Sfida të Thesarit të gjurmuesit" për të gjithë klasën, siç mund të jetë vendosja e një numri të caktuar kuponësh që duhet të kthejnë për të marrë një shpërblim. Mund ta masni vizualisht progresin duke bërë një "zinxhir" letrash me kuponët që sjellin.

**Shënimet e drejtuesit:**

- Është e rëndësishme t'i inkurajoni vazhdimisht prindërit për ta plotësuar sfidën për familjen që gjendet te Thesaret e gjurmuesit dhe te Gjurmuesi Junior. Kujtoju vazhdimisht dhe në mënyrë inkurajuese. Mos hiq dorë!
- Këto dy materiale jepen çdo javë me email. Për shkak të elementëve të ndërlikuar që kanë në projektim, nuk janë të ndryshueshme.
- Nëse nuk i keni printuar më parë këto materiale, rekomandojmë të praktikoni në kompjuterin që do të përdoret për printimin e dokumentit, duke përdorur shembullin e disponueshëm në faqen e anëtarëve.

# Shtojca

## Lidhja me Awana-ën

Programi i Zbuluesit u projektua fillimisht për të plotësuar programin e mesjavës së Awana-ës. Kur të gjitha programet e shërbesës së fëmijëve brenda një kishë plotësojnë njëra-tjetrën dhe nuk e konkurrojnë, është diçka shumë e fuqishme! Ata që marrin pjesë edhe tek Awana edhe te Zbuluesit, zakonisht dalin më mirë në testet e Zbuluesit dhe e kuptojnë më thellë Perëndinë, Fjalën e Tij dhe zbatimin e saj.

Programi i Zbuluesit dhe ai i Awana-ës e plotësojnë njëri-tjetrin në mënyrat e mëposhtme:

- Metododat disiplinuese janë të njëjta (numërimi deri në 5).
- 12 vargjet kyç të Zbuluesit gjenden te librat e Awana-ës.
- Nxënësit në programin e Awana-ës mësojnë shumë vargje përmendsh; te Zbuluesit theksohet më pak mësimi përmendsh dhe më shumë fakti se si një grup vargësh zbatohen në jetë.
- Ajo që mësohet te Zbuluesit përforcohet tek Awana përmes përdorimit të pikës “Vepro si duhet”, duke krijuar mësimet për grupe të mëdha që janë praktike dhe të zbatueshme.
- Ungjilli prezantohet në të njëjtën mënyrë si tek Awana dhe te Zbuluesit.
- Kanë qasje të balancuar për udhëzimet: Awana përdor mësimin në grupe të mëdha dhe Zbuluesit përdor mësimin në formën e mësimit në shkollë.

## Historia e “Discovery Land Global”

Pas shumë vitesh në zhvillimin e një filozofie të qartë dhe efektive për shërbesën, Kris Smoll, drejtuesja e shërbesës së fëmijëve në kishën “Appleton Alliance (AAC)”, po kërkonte një kurrikul që siguronte edhe argëtimin fizik dhe themelin e fortë biblik. Duke mos e gjetur dot, ajo bashkë me një vullnetar krijuan programin e Zbuluesit. Një kishë tjetër mësoi për programin dhe kërkoi ta përdorte. Kris ra dakord që të provonte se si do të funksiononte në një kishë tjetër. Sukses! Fjala u përhap dhe kisha të ndryshme në Shtetet e Bashkuara dhe nëpër botë po përdornin versionin anglisht. Kisha jonë motër në Lima, Peru pa se si po mësonin fëmijët dhe se si Perëndia po e përdorte programin dhe kërkuan ta përdornin edhe ata. Perëndia siguroi një përkthyes për ta bërë të disponueshme në spanjisht.

Për shkak se AAC ka një shërbesë të frytshme Awana, programi i Zbuluesit u zhvillua fillimisht për të plotësuar programin e Awana-ës. Në vitin 2016, DLG firmosi një kontratë bashkëpunimi me Awana – Latin America. Ne i kemi bashkuar skuadrat tona që t’u sigurojmë materiale për shërbesën e fëmijëve të gjitha shteteve spanjisht folëse.

Në vitet që kemi bashkëpunuar me kishat e tjera kemi mësuar se shërbesat e fëmijëve, të të gjitha përmasave, dëshirojnë më tepër se thjesht një kurrikul: ata duan trajnim, ide, strategji dhe burime që përkojnë me kurrikulën që po përdorin. Për këtë arsye, ne nuk e shesim kurrikulën. Në fakt, ne partnerizojmë me shërbesat e fëmijëve nëpër botë që t’i ndihmojmë të arrijnë dhe të dishepullojnë fëmijët në komunitetet e tyre për Krishtin!